

Vienë, 5 maj 2026

RBI gjeneroi një fitim të konsoliduar prej 209 milionë eurosh në grupin qendror (duke përfshirë Rusinë) në tremujorin e parë të vitit 2026

- ▶ Rezultati operativ u rrit me 12 % krahasuar me vitin e kaluar (duke përfshirë Rusinë), ndërsa të ardhurat kryesore u rritën me 5 % në 1,596 milionë euro
- ▶ Niveli i kredisë duke përfshirë Rusinë u rrit me 3 % nga fillimi i vitit
- ▶ Raporti i kapitalit të zakonshëm të nivelit të parë duke përfshirë Rusinë në 14.9 %

Raiffeisen Bank International (RBI) gjeneroi një fitim të konsoliduar prej 209 milionë eurosh në grupin qendror (duke përfshirë Rusinë), në tremujorin e parë të vitit 2026. Të ardhurat neto nga interesat u rritën me 3 % në 1,076 milionë euro nga viti në vit, ndërsa të ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet u rritën ndjeshëm me 11 % në 520 milion euro.

Arsyet kryesore për rënien e fitimit të konsoliduar në grupin qendror krahasuar me vitin e kaluar (rënie prej 19.6 %) ishin taksat më të larta bankare dhe rritja e kostove të riskut për shkak të ndikimeve makroekonomike të konfliktit në Iran.

Kreditë për klientët në grupin qendror u rritën me 3 % nga fillimi i vitit në 105 miliardë euro.

- ▶ *"RBI e ka filluar vitin financiar 2026 me një performancë pozitive. Niveli i fitimeve mbetet mjaft inkurajues", u shpreh Drejtori Ekzekutiv i RBI-së, Johann Strobl.*

Raporti CET1 prej 14.9 %

Raporti i kapitalit të zakonshëm të nivelit 1 (CET1) i RBI-së, duke përfshirë Rusinë, ishte 14.9 % në fund të tremujorit të parë 2026. Kjo shifër llogaritet bazuar në supozimin e rastit më të keq se Raiffeisen Bank International do të dekonsolidonte Raiffeisenbank Russia dhe do të humbiste investimin e plotë në kapital.

Politika e riskut për të ardhmen

Cilësia e portofolit të kredisë mbetet e lartë, me një raport NPE prej 1.6 % në fund të tremujorit të parë të vitit 2026. Kostot e riskut në grupin qendror arritën në 103 milionë euro, një rritje prej

56 milionë eurosh krahasuar me vitin e kaluar. Kjo rritje ishte si rezultat i dispozitave për të ardhmen të bëra në përgjigje të ndryshimeve në mjedisin makroekonomik në tregjet kryesore të RBI-së.

- ▶ *"Falë politikës sonë të riskut për të ardhmen, raporti ynë NPE është në nivelin më të ulët historik. Duke pasur parasysh ndikimin ekonomik të konfliktit në Iran, ne do të vazhdojmë ta ndjekim këtë politikë," shtoi Drejtori i Riskut i RBI-së, Hannes Mösenbacher.*

Transaksionet e M&A-së për të forcuar praninë në treg

Në tremujorin e parë, RBI njoftoi blerjen e Garanti BBVA Group Romania dhe më pas, në prill, bëri një ofertë tenderimi për aksionet e papaguara të Addiko Bank.

- ▶ *Drejtoresha e Departamentit të Financës së RBI-së, Kamila Makhmudova u shpreh se “Blerjet do të na mundësojnë të përforcojmë praninë tonë në treg në Rumani dhe Kroaci me një çmim të favorshëm dhe të rihyjmë në tregun slloven”.*

Reduktim i mëtejshëm i biznesit në Rusi

Libri i kredive në Raiffeisenbank Russia është reduktuar me 78 % që nga fillimi i luftës. Për më tepër, depozitat e klientëve u reduktuan ndjeshëm (41 % që nga shkurti i vitit 2022) për shkak të masave vendimtare, për shembull, klientët nuk marrin më interesa për depozitat e tyre. Të gjitha objektivat e reduktimit të biznesit u përmbushën në vitin 2025 dhe kufizimet do të mbeten në fuqi në vitin 2026.

Konflikti në Iran po ndikon perspektivën makroekonomike

Si rezultat i konfliktit në Lindjen e Mesme, ekspertët në Raiffeisen Research presin që furnizimet me naftë të mbeten të kufizuara për një periudhë kohe. Inflacioni i lartë, rritja e normave të interesit dhe pasiguria paraqesin rreziqe për konsumin dhe investimet në Evropë. Raiffeisen Research parashikon një ngadalësim të ndjeshëm të rritjes së PBB-së në Evropë, por nuk parashikon një recesion në vitin 2026. Në vitin 2027, pritet të rifillojë një rimëkëmbje ekonomike. Inflacioni në vitin 2026 pritet të nxitet nga çmimet më të larta të energjisë, me një rënie të mëvonshme në vitin 2027. Raiffeisen Research pret dy rritje të normave të interesit prej 25 pikësh bazë secila nga BQE këtë vit, me rritjen e parë që pritet të ndodhë në mbledhjen në qershor. Në Evropën Qendrore dhe Juglindore, ekspertët në Raiffeisen Research presin që shumica e bankave qendrore të mbajnë një qëndrim vigjilent, duke theksuar gatishmërinë e tyre për të ndërmarrë veprime.

Përmbledhje 2026

Udhëzimi i mëposhtëm i referohet RBI-së, duke përjashtuar Rusinë. Vetëm raporti CET1 është rishikuar pak për shkak të projekteve të shpallura të M&A-ve.

- ▶ Në vitin 2026, të ardhurat neto nga interesat priten të jenë rreth 4.4 miliardë euro, ndërsa të ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet rreth 2.1 miliardë euro.
- ▶ RBI pret që kreditë për klientët të rriten me rreth 7 % (duke përjashtuar blerjet).
- ▶ RBI pret që shpenzimet e përgjithshme administrative të jenë rreth 3.6 miliardë euro, duke rezultuar në një raport kosto/të ardhura prej rreth 52.5 %.
- ▶ Raporti i provigjionimit pritet të jetë rreth 35 pikë bazë.
- ▶ Kthimi i konsoliduar nga kapitali pritet të jetë rreth 10.5 % në vitin 2026.
- ▶ Në fund të vitit 2026, RBI pret një raport CET1 prej rreth 14.3 %* (duke përfshirë projektet e shpallura të blerjes).

*Me supozimin e dekonsolidimit të degës në Rusi me një raport çmim/vlerë kontabël prej zero.

Në terma afatmesëm, RBI synon të arrijë një kthim të konsoliduar nga kapitali prej të paktën 13 % duke përjashtuar Rusinë dhe duke përjashtuar provigjionet dhe kostot ligjore për kreditë në valutë të huaj në Poloni.

Tabelat e mëposhtme i referohen RBI, duke përjashtuar Rusinë:

Pasqyra e të Ardhurave në milionë euro	T1/2026	T1/2025	Ndryshimi	
Të ardhurat neto nga interesi	1.076	1046	30	2.9%
Të ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet	520	466	53	11.4%
Të ardhura neto nga tregtimi dhe rezultati i vlerës së drejtë	5	(27)	32	-
Shpenzime të përgjithshme administrative	(896)	(850)	(46)	5,4%

Rezultate operative	760	678	81	12.0%
Rezultate të tjera	(86)	(66)	(20)	30,1%
Masat qeveritare dhe kontributet e detyrueshme	(177)	(116)	(62)	53,1%
Humbjet nga zhvlerësimi nga aktivet financiare	(103)	(46)	(56)	121,3%
Fitimi/humbja përpara tatimit	393	450	(56)	(12.5)%
Fitimi/humbja pas tatimit	258	318	(59)	(18.7)%
Fitimi i konsoliduar	209	260	(51)	(19.6)%

Pasqyra e të Ardhurave në milionë euro	T1/2026	T4/2025	T1/2025	Ndryshimi			
				T1/2026 kundrejt T1/2025	T4/2025 kundrejt T1/2025	T1/2026 kundrejt T4/2025	T1/2025 kundrejt T4/2025
Të ardhurat neto nga interesi	1.076	1054	1046	22	2.1%	30	2.9%
Të ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet	520	529	466	(9)	(1.7)%	53	11.4%
Të ardhura neto nga tregtimi dhe rezultati i vlerës së drejtë	4	(18)	(27)	23	-	32	-
Shpenzime të përgjithshme administrative	(896)	(894)	(850)	(2)	0,3%	(46)	5,4%
Rezultate operative	760	736	678	24	3.2%	81	12.0%
Rezultate të tjera	(86)	(13)	(66)	(74)	>500,0%	(20)	30,1%
Masat qeveritare dhe kontributet e detyrueshme	(177)	(49)	(116)	(129)	263,7%	(62)	53,1%
Humbjet nga zhvlerësimi nga aktivet financiare	(103)	(72)	(46)	(31)	42,5%	(56)	121,3%
Fitimi/humbja përpara tatimit	393	603	450	(209)	(34.7)%	(56)	(12.5)%
Fitimi/humbja pas tatimit	258	478	318	(220)	(45.9)%	(59)	(18.7)%
Fitimi i konsoliduar	209	416	260	(207)	(49.7)%	(51)	(19.5)%

Pasqyra financiare në milionë euro	31/3/2026	31/12/2025
Kredi ndaj konsumatorëve	104.702	101195
Depozita nga klientët	122.943	117277
Totali i aktiveve	201.472	193191
Totali i aktiveve të ponderuara ndaj riskut (RWA)	84.410	80932

Informacion specifik për bankat	31/3/2026	31/12/2025
Raporti NPE	1,6%	1,7%
Raporti i mbulimit të NPE	46,4%	44,2%
Raporti CET1 i përkohshëm (përfshirë fitimin)	14,9%	15,5%
Raporti i përgjithshëm i kapitalit të përkohshëm (përfshirë fitimin)	19,7%	20,3%

Raportet kyçe	T1/2026	T1/2025	T4/2025
Marzhi i interesit neto (aktive me interes 0)	2,25%	2,31%	2,26%
Raporti kosto/të ardhura	53,4%	55,0%	54,1%
Raporti i huadhënies (Ø kredi për klientët)	0,36%	0,20%	0,37%
Kthimi i konsoliduar nga kapitali	5,2%	7,3%	12,4%
Fitimi për aksion në EUR	0,54	0,71	1,16

Për më shumë informacion, ju lutemi kontaktoni:
Christof Danz (+43-1-71 707-1930, christof.danz@rbinternational.com)
www.rbinternational.com

* * * * *

RBI e konsideron Austrinë, ku operon si një bankë kryesore korporative dhe investimi, dhe Evropën Qendrore dhe Lindore (EQL) si tregun e saj vendas. 11 tregje në rajon mbulohen nga filialet, dhe Grupi RBI përfshin gjithashtu shumë shoqëri të tjera të shërbimeve financiare, për shembull në fushat e lizingut, menaxhimit të aktiveve dhe M&A (Bashkim dhe Blerje të Shoqërive).

Rreth 42,000 punonjës u shërbejnë 18,6 milionë klientëve në rreth 1,300 degë, shumica dërrmuese e të cilave ndodhen në rajonin e Evropës Qendrore dhe Lindore. Aksionet e RBI-së janë të renditura në Bursën e Vjenës. Bankat rajonale Raiffeisen mbajnë rreth 61.2 përqind të RBI-së, ndërsa pjesa tjetër është në qarkullim të lirë. Brenda Grupit Bankar Raiffeisen, RBI është institucioni qendror i bankave rajonale Raiffeisen dhe institucioneve të tjera të lidhura me institucionet financiare.